



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 33 prot.

Kamëz, më 16.03 2021

V E N D I M

Nr. 28 Datë 16.03 .2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËR FITUESVE TË PROGRAMIT "PËRMIRSIMI I
KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA
FAVORIZUARA" PËR VITIN 2021

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 16.03.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin Nr.25, Datë 11.03.2021, në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23,24, Ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social", neni 73 gërma "d", VKM nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit", në zbatim të shkresës me Nr.657.Prot datë 14.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021", VKB nr.14 dt 19.02.2021 "Për sistemin e pikëzimit, për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" si dhe relacionit të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I :

1. Miratimin e shumës financiare prej 20,760,073 (njëzet milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë, për vitin 2021, për familjet që banojnë në Bashkinë Kamëz, dhe që përfitojnë nga programi "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", dërgimin për bashkëfinancim (60%-40%) në masën prej 12,456,044 (dymbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyzet e katër) lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me vlerë 8,304,029 (tetë milion e treqind e katër mijë e njëzet e nëntë) lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Programit me Gr 0, prog 06180, art 606 për zhvillimin e strehimit.
2. Bashkëngjitur këtij vendimi gjeni listën e familjeve përfituese.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Perfekti i Qarkut Tiranë

Z V / K R Y E T A R

